

**AKT THEMELIMI DHE STATUTI I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR**  
**“ENVIRO STUDY” sh.p.k**

Sot , më datë **01.11.2024** (dymijë e njëzet e katër) në Tiranë , në përputhje me ligjin nr 9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” dhe Ligjit nr. 9723, datë 03.05.2007 “Për regjistrimin e biznesit”, i ndryshuar, anëtarët themelues si më poshtë:

1. **Znj. Ledjana Bojaxhi**, shtetase shqiptare, e datëlindjes 02.01.1984, lindur në Berat dhe banuese në Tiranë, me pasaportë shqiptare me nr. BB7949849 , madhore dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar;
2. **Znj. Gea Baduni**, shtetase shqiptare, e datëlindjes 05.06.1993, lindur dhe banuese në Tiranë, me pasaportë shqiptare me nr. BC0958342, madhore dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar;

të cilët në vijim do të quhen “Ortakë”, me vullnetin e tyre të lirë dhe të plotë, të shprehur nëpërmjet këtij Akti Themelimi dhe Statuti, ranë dakord të themelojnë shoqërinë me përgjegjësi të kufizuar “ENVIRO STUDY” shpk me kushtet e mëposhtme.

**KREU I**

**EMRI I SHOQËRISË, SELIA, KOHËZGJATJA, OBJEKTI**

**NENI 1**

**EMRI I SHOQËRISË**

- 1.1.Emri i shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar është “ENVIRO STUDY” shpk. (Në vijim e quajtur “Shoqëria”)
- 1.2.Shoqëria organizohet në formën e një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar në përputhje me ligjet e Republikës së Shqipërisë.
- 1.3. Shoqëria ka logon dhe vulën e saj zyrtare.

**NENI 2**

**SELIA**

- 2.1. Selia e shoqërisë ndodhet në adresën: Bulevardi ‘Zogu i Parë’, QTT, Zona kadastrale 8360, Volumi 15, Fq.137, Nr.Pasurie 1/220-N22, Tiranë,1001.
- 2.2. Organi administrues i Shoqërisë mund të themelojë ose mbyllë degë dhe /ose zyra përfaqësimi, brenda apo jashtë Republikës së Shqipërisë.

### **NENI 3**

## **KOHËZGJATJA**

- 3.1 Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj për një periudhë kohore të palimituar.

### **NENI 4**

## **OBJEKTI**

- 4.1. Shoqëria ka për objekt të saj kryerjen e të gjithë aktiviteteve që një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar ushtron në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi, duke u fokusuar në fushat dhe aktivitetet e mëposhtme:

#### **a. Në fushën e mjedisit dhe ujit**

-Kryerja e çdo lloj shërbimi në fushën e mjedisit dhe jo vetëm, duke përfshirë konsulencë mjedisore, teknike, ligjore, ekonomike, si dhe procedurat administrative për pajisjen me leje apo licenca, për klientë publikë dhe privatë.

-Hartimi i studimeve të fizibilitetit dhe menaxhimi i projekteve në mjedis dhe fushën e mbetjeve, duke përfshirë studimet hidrologjike, gjeologo-inxhinierike, socio-ekonomike.

-Hartimi i studimeve mjedisore dhe sociale, studimeve të vlerësimit të ndikimit në mjedis (VNM), vlerësimeve strategjike mjedisore (VSM), të gjitha të përgatitura sipas standardeve kombëtare dhe ndërkombëtare;

- Ndjekja e procedurave për lejet e mjedisit;

-Kryerja e studimeve/monitorimeve dhe zbatimi i projekteve në mjedis, duke përfshirë monitorimin mjedisor për shkarkime në mjedis, biodiversitetin, ndryshimet klimatike, emetimin e gazrave në mjedis, ajri, zhurmat etj;

-Ofrim ekspertize për “due diligence”;

-Ofrimi i trajnimeve për subjekte publike dhe private me fokus parandalimin e ndotjes, riskut në mjedis, menaxhimin e mbetjeve, ndryshimet klimatike, biodiversitetin, rehabilitimin e mjedisit nga ndotja, ruajtjen e mjedisit në ambientet e punës, ndotjet e ujit, ruajtja e mjedisit ujor;

-Vlerësimi i dëmit mjedisor;

- Hartimi dhe zbatimi i projekteve për pastrimin dhe rehabilitimin e zonave të mbrojtura;
- Kryerja e analizave laboratorike për matjen e parametrave të cilësisë së ujërave sipërfaqësore, ujit të pijshëm, tokës dhe ajrit, si dhe shkarkimeve të çdo lloji të industrisë së mjedisit;
- Hartimi i planeve të menaxhimit, Masterplaneve, si dhe planeve rajonale për pyjet, kullotat, burimet ujore, Ujësjellës Kanalizimet;
- Ekseprtizë për çështjet që lidhen me Furnizimin me Ujë, Kanalizimet dhe Trajtimin e Ujërave të Ndotur urbanë, industrialë, bregdetarë etj;
- Veprimtari në fushën e mbrojtjes ndaj zjarreve, nëpërmjet studimeve dhe projekteve mbi masat e mbrojtjes nga zjarri.

**b. Në fushën e pasurive të paluajtshme:**

- Hartimi i raporteve të vlerësimit të pasurive të paluajtshme.

**c. Në fushën e efijencës së energjisë:**

- Konsulencë, trajnime, studime për Auditimin e Efijencës së Energjisë;
- Ofrimi i shërbimit “Menaxher Energjie” për konsumatorët e mëdhenj të energjisë.

**ç. Në fushën e kulturës:**

- Ushtrimi i veprimtarisë në fushën e arkeologjisë dhe trashëgimisë kulturore;
- Projektim dhe restaurim i monumenteve të trashëgimisë së arkitekturës, veprave të artit dhe objekteve muzeale.

4.2. Për përmbushjen e objektit të saj Shoqëria mund të lidhë kontrata shërbimi me ekspertë të tjerë të licencuar me qëllim përmbushjen e objektit të saj.

## **KREU II**

### **KAPITALI SHOQËRISË, KALIMI I KUOTAVE, ZMADHIMI DHE ZVOGËLIMI I KAPITALIT**

#### **NENI 5**

### **KAPITALI I SHOQËRISË**

5.1. Kapitali themeltar i shoqërisë është 1000 lekë (Njëmijë lekë) i përbërë nga 2 (dy) kuota.

5.2. Kapitali i shoqërisë paguhet nga ortakët që zotërojnë secili nga 50% (pesëdhjetë për qind) të kontributeve në kapitalin e shoqërisë.

5.3. Kapitali i shoqërisë përbëhet, nga kapitali fillestar plus shtesën e bërë, mjetet e xhiros, pasuri të luajtshme ose të paluajtshme, të nevojshme për ushtrimin e aktivitetit të shoqërisë.

5.4. Kuotat e kapitalit janë të pasqyruara dhe të regjistruara në librat e llogarisë së shoqërisë.

5.5. Fitimet që realizohen gjatë veprimtarisë dhe që konkretizohen me nxjerrjen e bilanceve periodike, ndahen midis ortakëve në proporcion me përqindjen e kapitalit të investuar, por kurdoherë pasi të jenë shlyer detyrimet ligjore.

## **NENI 6**

### **KALIMI I KUOTAVE**

6.1. Në rast se një prej ortakëve ka ndërmend të shesë kuotat e tij tërësisht, apo pjesërisht duhet me parë të njoftojë ortakun tjetër të shoqërisë. Ortaku tjetër ka të drejtën e blerjes së parë. Këtë të drejtë, ortaku duhet ta ushtrojë brenda 30 ditëve nga dita e njoftimit me shkrim.

6.2. Në rastin e mos ushtrimit të së drejtës së blerjes së parë, ortaku që do të shesë kuotat duhet të njoftojë emrin e blerësit dhe kushtet, të cilat nuk duhet të jenë më të favorshme se sa ato të ofruara nga ortaku tjetër i shoqërisë.

6.3. Heqja dorë e njërit prej ortakëve nga bashkëpunimi nuk e çliron ortakun e larguar nga detyrimet që kanë lindur para se ai të largohet. Po kështu ai fiton dhe të drejtat që janë krijuar para largimit të tij.

## **NENI 7**

### **ZMADHIMI DHE ZVOGËLIMI I KAPITALIT**

7.1. Në rast zmadhimi të kapitalit, të dy ortakët do të kenë të drejtën të nënshkruajnë zmadhimin e kapitalit, në para ose me kontribute në natyrë, në përpjestim të drejtë me kuotat që zotërojnë në Shoqëri.

7.2. Kapitali mund të shtohet ose të pakësohet sipas vendimit të asamblesë së ortakëve themelues. Kuota e pjesëmarrësve në kapital janë të gjitha të emëruara dhe të pa ndashme. Kapitali është tërësisht i shlyeshëm dhe i nënshkrueshëm. Çdo kuote i takon e drejta e një vote.

7.3. Në çdo rast kapitali i Shoqërisë nuk mund të zvogëlohet nën kufirin e përcaktuar me ligj.

### **KREU III**

#### **NENI 8**

#### **ASAMBLEJA E PËRGJITHSHME**

8.1. Asambleja e Përgjithshme është organi më i lartë vendimmarrës i Shoqërisë. Vendimet e Asamblesë së Përgjithshme, në përputhje me legjislacionin në fuqi, janë të detyrueshme për të gjithë Ortakët, pavarësisht janë apo jo të pranishëm në mbledhje, janë apo jo dakord me këto vendime.

8.2. Asambleja e Përgjithshme ka funksionet e mëposhtme:

- Përcakton politikat tregtare dhe ekonomike të Shoqërisë dhe mbikëqyr zbatimin e këtyre të fundit nga administratorët;
- Emëron dhe shkarkon administratorët;
- Emëron dhe shkarkon ekspertin(ët) kontabël dhe/ose likuiduesin(ët) e Shoqërisë;
- Përcakton shpërblimin e administratorëve, ekspertëve kontabël dhe likuiduesve;
- Miraton pasqyrat financiare vjetore dhe raportet e ecurisë së veprimtarisë të përgatitura nga administratorët;
- Merr vendim për ndryshimet e këtij Statuti dhe të Aktit të Themelimit;
- Merr vendim për zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të Shoqërisë;  
Merr vendim për shpërndarjen e fitimeve dhe mbulimin e humbjeve;
- Merr vendim për riorganizimin e Shoqërisë ose prishjen e saj;
- Merr vendim për çdo çështje tjetër të parashikuar nga ligji.

#### **NENI 9**

#### **THIRRJA**

- 9.1. Mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme mund të thirret nga Administratori(rët) apo secili prej Ortakëve sipas legjislacionit në fuqi.
- 9.2. Mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme zhvillohet normalisht në selinë e Shoqërisë ose në një vend tjetër brenda ose jashtë Republikës së Shqipërisë.
- 9.3. Asambleja e Përgjithshme shprehet në mënyrë të veçantë për çdo çështje të rendit të ditës, për të cilën duhet të merret një vendim i veçantë.
- 9.4. Ortakët mund të marrin pjesë në Asamblenë e Përgjithshme personalisht ose nëpërmjet përfaqësuesit të autorizuar me prokurë. Administratori(ët) e Shoqërisë nuk mund të përfaqësojnë Ortakët në Asamblenë e Përgjithshme.

## **NENI 10**

### **PROCESI I VENDIMARRJES**

- 10.1. Asambleja e Përgjithshme mblidhet sa herë që është e nevojshme, por në çdo rast të paktën një herë në vit.
- 10.2. Asambleja e Përgjithshme quhet e mbledhur rregullisht kur janë të pranishëm Ortakët me të drejtë vote që zotërojnë më shumë se 30% të kuotave të Shoqërisë. Në mungesë të kuorunit të kërkuar, mbledhja shtyhet për 30 (tridhjetë) ditë, me të njëjtin rend dite.
- 10.3. Asambleja e Përgjithshme merr vendime me shumicë të thjeshtë, në lidhje me çështje për të cilat ligji nuk kërkon një shumicë të cilësuar, përcaktuar në pikën 10.4 më poshtë.
- 10.4. Asambleja e Përgjithshme vendos me shumicë të cilësuar prej  $\frac{3}{4}$  e votave të ortakëve të pranishëm në lidhje me:
  - i. Ndryshimin e Statutit;
  - ii. Rritjen dhe zvogëlimin e kapitalit;
  - iii. Shpërndarjen e fitimeve dhe mbulimin e humbjeve;
  - iv. Riorganizimin dhe prishjen e Shoqërisë.
- 10.5. Asambleja e Përgjithshme për vendimet sipas pikës 10.4 quhet e mbledhur rregullisht kur janë të pranishëm Ortakët që zotërojnë më shumë se 50% të kuotave të Shoqërisë. Në mungesë të kuorunit të kërkuar, mbledhja shtyhet për 30 (tridhjetë) ditë, me të njëjtin rend dite.

## **KREU IV**

### **KOMPETENCAT E ORTAKUT, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I SHOQËRISË**

## NENI 11

### KOMPETENCAT E ORTAKUT

11.1. Ortaku ka të drejtë të administrojë aktivitetin e shoqërisë, konform objektit të veprimtarisë së saj.

11.2. Ka të drejtë të marrë dijeni për rezultatet ekonomiko financiare në çdo fazë të aktivitetit të saj.

11.3. Ka të drejtë të tërheqë të gjitha dokumentat kryesore të shoqërisë për tre vitet e fundit.

11.4. Ortakët rezervojnë të gjitha të drejtat sipas ligjit Tregtar.

## NENI 12

### DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I SHOQËRISË

12.1. Administratori i parë i shoqërisë është:

**Znj.Gea Baduni**, shtetase shqiptare, e datëlindjes 05.06.1993, lindur dhe banuese në Tiranë, me pasaportë shqiptare me nr. BC0958342.

12.2. Administratori i dytë i shoqërisë është:

**Znj. Ledjana Bojaxhi**, shtetase shqiptare, e datëlindjes 02.01.1984, lindur në Berat dhe banuese në Tiranë, me pasaportë shqiptare me nr. BB7949849.

12.3. Administratori ka të gjithë të drejtat dhe fuqitë për drejtimin e zakonshëm të shoqërisë, me qëllim që të arrijë objektivat e saj.

12.4. Administratori përfaqëson shoqërinë në marrëdhënie me të tretët si dhe para organeve të administratës dhe atyre gjyqësore.

12.5. Administratori do të veprojë në çdo kohë vetëm në interesin më të mirë të Shoqërisë.

12.6. Shoqëria administrohet të paktën nga 1(një) dhe maksimumi 3(tre) administratorë, të cilët qëndrojnë në detyrë deri në revokimin apo dorëheqjen për një periudhë maksimale prej (5 vjetësh).

12.7. Çdo administrator do të ketë të drejtë për rimbursimin e shpenzimeve të bëra prej tij për llogari të shoqërisë.

**KREU V**  
**EKSPERTI FINANCIAR, KONTROLI FINANCIAR I SHOQËRISË, VITI**  
**FINANCIAR, BILANCI VJETOR**

**NENI 13**  
**EKSPERTI KONTABËL**

13.1 Shoqëria cakton një ekspert kontabël për çdo vit financiar. Caktimi i tyre bëhet nga administratori.

13.2. Eksperti kontabël mban përgjegjësi për mirëmbajtjen e rregullt të gjithë dokumentacionit të shoqërisë.

13.3. Eksperti kontabël përgjigjet për dëmet që i vijnë shoqërisë nga mbajtja e pa rregullt e llogarive ose verifikimi i tyre i gabuar.

**NENI 14**  
**KONTROLI FINANCIAR**

14.1. Kontrolli financiar i Shoqërisë kryhet në përputhje dhe sipas legjislacionit shqiptar në fuqi.

**NENI 15**  
**VITI FINANCIAR**

15.1. Viti financiar i Shoqërisë fillon më 1 Janar dhe përfundon më 31 Dhjetor të çdo viti.

15.2. Përjashtimisht viti i parë financiar përfshin kohën nga data e regjistrimit të shoqërisë në regjistrin tregtar dhe përfundon më 31 dhjetor të po atij viti.

**NENI 16**  
**BILANCI VJETOR**

16.1. Shoqëria do të mbajë një kontabilitet të rregullt të pasurisë dhe të veprimtarisë së saj në pajtim me kërkesat ligjore.



16.2. Në mbylljen e çdo viti financiar administratori dhe eksperti kontabël harton inventarët dhe llogaritë vjetore në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi për kontabilitetin si dhe një raport që pasqyron gjendjen e shoqërisë gjatë vitit financiar të kaluar.

16.3. Bilancet vjetore, inventari, raportet e administratorit dhe ekspertit kontabël te autorizuar (nëse është emëruar) miratohen nga ortakët sipas Ligjit Nr. 9901 datë 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”.

**KREU VI**  
**MARRËDHËNIET E PUNËS, PRISHJA DHE LIKUIDIMI, LIGJI I**  
**ZBATUESHËM, ZGJIDHJA E MOSMARRËVESHJEVE**

**NENI 17**  
**MARRËDHËNIET E PUNËS**

17.1. Marrëdhëniet e punës në shoqëri rregullohen nëpërmjet kontratave të punës. Për çështjet që ky akt nuk i parashikon zbatohen dispozitat përkatëse të legjislacionit shqiptar në fuqi.

**NENI 18**  
**PRISHJA DHE LIKUIDIMI**

18.1. Në rastin e prishjes dhe likuidimit të shoqërisë do të zbatohen dispozitat e parashikuara në ligjin “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”.

**NENI 19**  
**LIGJI I ZBATUESHËM**

19.1. Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj në përputhje të plotë me këtë akt themelimi e statut dhe ligjin shqiptar. Për sa nuk është parashikuar në këtë akt, do të zbatohen dispozitat e legjislacionit shqiptar në fushën e shoqërive tregtare.

**NENI 20**  
**ZGJIDHJA E MOSMARRËVESHJEVE**

20.1. Mosmarrëveshjet që mund të lindin në Shoqëri, do të zgjidhen miqësisht ndërmjet palëve të interesuara. Në rast se palët nuk arrijnë një zgjidhje miqësore, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë do të jetë kompetente për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve.

## **KREU VII**

### **DISPOZITAT KALIMTARE**

#### **NENI 21**

#### **DISPOZITAT E FUNDIT**

21.1. Për të gjitha çështjet që nuk gjejnë rregullim në këtë Akt Themelimi dhe Statut, aplikohen dispozitat e Ligjit Nr. 9901 datë 14.04.2008” Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”.

21.2. Për efekt të interpretimit të këtij Statuti me “Ligj Tregtar” nënkuptohet Ligji nr. 9901 datë 14.04.2008 “Për Shoqëritë Tregtare”.

21.3. Pavlefshmëria eventuale të dispozitave të veçanta të Statutit nuk mund të çënojë vlefshmërinë e tij.

#### **NENI 22**

#### **HYRJA NË FUQI**

22.1. Ky Statut dhe Akt themelimi hyn në fuqi dhe është i detyrueshëm për zbatim në momentin e nënshkrimit nga Ortakët.

Ky Akt Themelimi dhe Statut hartohet dhe nënshkruhet në 3 (tre) kopje në gjuhën shqipe.

### **ORTAKËT THEMELUES TË SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR “ENVIRO STUDY”**

**LEDJANA BOJAXHI**

**GEA BADUNI**

